



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT



Në bazë të nenin 22 paragrafi 7 dhe nenit 23 paragrafi 1 nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave (Gazeta zyrtare e Republikë së Maqedonisë, numër 12/2019) dhe nenin 40 paragrafi 4 dhe nenit 41 nga Rregullorja për punë e Komisionit shtetëror për parandalim të korrupsionit (KSHPK), Komisioni shtetëror duke vepruar pas denoncimit me akuaza për ekzistim të konfliktit të interesave nga parashtrues i njohur, në senacën e 46-të të mbajtur me datë 12.02.2021, morri

### VENDIM

Akuzat e ekzistimit të konfliktit të interesave në procedurën kundër anëtarëve të Këshillit të komunës ..... **JANË TË BAZUARA.**

Vendimi i Këshillit të Komunës ..... për miratim të pëlqimit për planin vjetor për punësime në ..... për vitin 2021 për të cilën kanë votuar anëtarët e Këshillit ....., e miratuar në seancën e 35-të të Këshillit të mbajtur me datë 10.09.2020 është marrë në gjendje të konfliktit të interesave, gjë që është në kundërshtim me nenin 44 paragrafi 5 nga Ligji për vetqeverisje lokale në lidhje me nenin 72 dhe 75 nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave.

**Ngritet procedurë për kundërvajtje** kundër ..... anëtarë të Këshillit të komunës ....., për kryrje të shkeljes së nenin 72 dhe 75 nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave, dënuar sipas nenin 107 paragrafi 1 alinea 2 nga ligji i njëjtë.

Lënda me numër 09-3413/1 me datë 01.10.20209 të mbyllet dhe të arkivohet.

### SQARIM

Lënda me numër 09-3431/1 me datë 01.10.2020 e formuar në bazë të denoncimit të arritur nga parashtrues i njohur kundër antarëve të Këshillit të Komunës .....

Në denoncim theksohet se anëtarët e emërtuar kanë marrë pjesë në votimin për miratim të vendimeve lidhur me punën e institucionit në të cilën janë të angazhuar me punë, i cili institucion është e themeluar nga Komuna.

Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit me qëllim të përcaktimit të gjendjes faktike dhe vërtetimit të akuzave në denoncim, deri tek Komuna ..... dorëzoi kërkesë për sigurim të dokumentacionit dhe atë: procesverbal nga senaca e 35-të e mbajtur me datë 27.08.2020, ku është konstatuar prezenca dhe votimit i anëtarëve të Këshillit të komunës ..... dhe se vallë anëtarët e përmendur janë të punësuar në IAPKF .....

Me shkrimin e dorëzuar deri tek KSHPK nga Komuna ..... vërtetohet se akuzat, gjegjësisht këshilltarët e përmendur kanë votuar për miratim të vendimit lidhur me punën e institucionit në të cilën janë të angazhuar me punë.

Duke pasë parasysh të theksuarën më sipër, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit në seancën e 46-të të mbajtur me datë 12.02.2021, morri vendim me të cilën në rastin konkret vërtetohen akuzat në denoncim sipas të cilën anëtarët e përmendur të Këshillit të komunës ..... kanë marrë pjesë në seancën e Këshillit dhe kanë votuar duke mos e paraqitur

interesat private dhe duke mos u përjashtuar nga diskutimi për miratim të vendimeve lidhur me punë e institucionit të themeluar nga Komona në të cilën janë të angazhuar me punë, me çka kanë vepruar në kundërshtim me nenin 44 paragrafi 5 nga Ligji për vetqeverisje lokale – *anëtari i këshillit i punësuzar në shërbimet publike në të cilat i ka themeluar komuna, nuk mund të merr pjesë në procesin e vendimmarrjes për çështje që kanë të bëjnë me shërbimet publike në të cilën është i punësuar, kurse në lidhje me nenin 72 dhe 75 nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave:*

*Veprimi në rast të ekzistimit të konfliktit të interesave*

*Nenin 72*

- (1) Personi zyrtar në punën e vet, është i obliguar të ket kujdes nga konflikti potencial i interesave dhe të ndërmer masa për menjanim të tyre.*
- (2) Në rast të dyshimit për ekzistim të konfliktit të interesave, personi zyrtar është i obliguar t'i ndërmer të gjitha masat e nevojshme që të pengon ndikimin e interesave private të tij ose interesave private të personit tjetër gjatë realizimit të autorizimeve dhe obligimeve dhe për atë ta informon eprorin e tij.*
- (3) Në rast të ekzistimit të dyshimeve për konflikt të interesave, personi zyrtar është i obliguar të kërkon mendim nga Komisioni shtetëror.*

*Përjashtim*

*Nenin 75*

- (1) Kur personi zyrtar do të kupton për rrethanat që flasin për ekzistim të konfliktit të inetersave ose të konfliktit potencial të interesave, është i obliguar të kërkon përjashtim dhe të ndërpresë veprimin e vet.*
- (2) Personi zyrtar do të përjashtohet nga kryerja e veprimit të caktuar me vendim të organit në të cilin është i zgjedhur ose i emëruar, gjegjësisht ku e kryen funksionin, autorizimin publik ose detyrën zyrtare dhe me kërkesë të personit të interesuar i cili ka kuptuar për rethanat që flasin për ekzistim të konfliktit të interesave ose të konfliktit potencial të interesave.*

Në përputhje me nenin 107 paragrafi 1 alinea 2 nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave ngritet procedurë për kundërvajtje kundër ..... anëtarë të Këshillit të komunës së ....., sepse nuk e kanë lajmëruar konfliktin e interesave dhe nuk kanë kërkaur përjashtim para vendimmarrjes lidhur me punën e institucionit në të cilin janë të angazhuar me punë, me të cilën mënyrë kanë vepruar në kundërshtim me nenin 72 dhenenin 75 nga ligji i njëjtë.

Duke pasë parasyshë të shënuarën më sipër, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit vendosi sipas dispozitave të këtij vendimi.

**Është vendosur me datë 12 shkurt të viti 2021, me numër 09-3431/6**

КОМИСИОНИ ШТЕТЁРОР ПЁР  
PARANDALIM ТЁ КОРРУПСИОНИТ  
Kryetarё: Biljana Ivanovska

Pas pёrfundimit тё KSHPK  
Pёrpunoi: B. Xh., кёshilltarё  
Miratoi: m-r V. G., anёtar i KSHPK  
Dorёzuar deri tek: Arkiva, parashtguesi

